



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 588 prot.

Tiranë, më 15 .04. 2024

V E N D I M

Nr. 98, datë 15 .04 . 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 50, datë 29.03.2023, paraqitur nga një grup personash, znj. A.H, z. Y.V, znj. L.V, z. A.V, znj. F.V, z. G.D, znj. A.D, z. M.K, znj. Sh.K, z. A.K dhe znj. A.K, kundër Këshillit Bashkiak Berat, Bashkisë Berat, Kryetarit të Bashkisë Berat, Administratorit të Njesisë Administrative Sinjë dhe Drejtorisë së Mirëmbajtjes së Rrugëve, pranë Bashkisë Berat, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të *gjendjes ekonomike, gjendjes arsimore dhe vendbanimit*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, ankuesit parashtrojnë se:

Fëmijët e fshatrave Mbolan, Levan, Velçan dhe Cuke, janë në një gjendje të mjerueshme social-ekonomike dhe ju mohohet dhe shkelet e drejta e jetës, e drejta për arsim dhe e drejta për të gëzuar shëndet të plotë. Këto të drejta iu mohohen nga Këshilli Bashkiak Berat, Njësia Administrative Sinjë, Bashkia Berat, Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtori i Mirëmbajtjes së Rrugëve pranë kësaj bashkie.

Ankuesit parashtrojnë se, fëmijët e këtyre fshatrave që të edukohen, nga arsimi parashkollor deri në mbarimin e shkollës së mesme, duhet të shkojnë në qendrën e Njesisë Administrative

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Sinjë, në Shkollën e Mesme të Bashkuar Jani Dodi. Kjo shkollë ndodhet larg shtëpive të tyre me kilometra të tëra. Për transportimin e këtyre fëmijëve është në dispozicion vetëm një furgon privat. Ky furgon në shumicën e rasteve gjatë dimrit nuk mund të shkojë tek shtëpitë e banorëve sepse rruga është mjaft e vështirë dhe e pakalueshme. Nga frika se furgoni bie në humnerë, shoferi refuzon të bëjë rrugën. Fëmijëve nga mosha 7 vjeçare deri në 18 vjeç u duhet të bëjnë kilometra të tërë në këmbë deri sa të dalin në rrugën kryesore. Në shumicën e rasteve prindërit refuzojnë të lënë fëmijët të shkojnë nga frika se mos fëmija merr të ftohtë. Kur bie shi dhe borë, fëmijët nuk shkojnë në shkollë dhe për rrjedhojë humbasin orët e mësimi. Për fëmijët e shkollave deri 9 vjeçare, Bashkia e Beratit paguan detyrimin e transportit. Për fëmijët e shkollës së mesme banorët duhet të paguajnë tarifën private të cilat janë të konsiderueshme për burimet e pakta financiare të fshatarëve të kësaj zone. Shumica e banorëve nuk kanë të ardhura financiare të mjaftueshme për të mbajtur familjet. Vendi është malor dhe prodhimet bujqësore janë të pakta. Në këto kushte gjendja e tyre është e mjerueshme.

Ankuesit theksojnë se, prej 31 vitesh nuk është vënë dorë për të rregulluar rrugët e fshatit në Njësinë Administrative Sinjë, në Bashkinë e Beratit. Këto rrugë janë në pakalueshme nga mjetet motorrike, janë me gropa, pa nivel, pa tubacione dhe erozioni ka bërë humnera të rrezikshme përgjatë tyre. Në këto kushte lagje të tjera janë të paaksesueshme. Në fshatin Sinjë, ku ndahen rrugët për fshatrat Cuke, Velcan, Osmezë, Plashnik dhe Levan, kthesa e Cukës është një vend shumë problematik. Kërkesat e vazhdueshme të banorëve të këtyre fshatrave, nuk kanë marrë përgjigje nga pushteti vendor, ndërsa një prej ankuesve, znj. A.H deklaron se është ankuar personalisht, por premtimet e tyre nuk janë mbajtur.

Ankuesit shpjegojnë se, në dokumentacionin e Bashkisë Berat, rruga Sinjë-Vecan, figuron e shtruar me asfalt, por në realitet është me baltë dhe gurë të pasistemuar. Rreshjet e shumta kanë bërë kanal në mes të kësaj rruge. Në fillim të rrugës së Levanit, tek Shelqet, gropat e ujit janë kaq të thella sa nuk duket rruga dhe ka mundësi që mjeti të bjerë në kanal. Në vazhdimësi rruga është shumë e paniveluar. Tek kthesa, Qafa Rraut, proji e ka marrë rrugën dhe nuk kalon dot. Tek Kullsit, furgoni i pret fëmijët në rrugë pasi një rreshje e vogël e bën të pakalueshme rrugën nga humnera. Pa shkuar te shkolla, është një përrua i madh mbi të cilin ura e ndërtuar që në kohën e kooperativave është rrënuar fare dhe është e pakalueshme. Lagja Dulaj, Mucaj, Hoxhaj, Rizaj, janë komplet të izoluar sepse rrugët janë decimuar me kalimin e kohrave. Lagja Bazaj, është e pa shtruar, asnjë gur. Lagja Vahaj është e paarritshme, sepse nuk kalon dot tek humnera. Nëqoftëse ndodh ndonjë sëmundje ose fatkeqsi nuk mund të vijë ndihma as për 24 orë.

Ankuesit pretendojnë se Bashkia Berat diskriminon banorët e këtyre fshatrave sepse ata janë të varfër, të plakur dhe banojnë në vend malor. Ankuesit theksojnë se, aktualisht Sinja është e vetmja Njësi Administrative e Bashkisë Berat që vit pas viti humbet popullsi të konsiderueshme, duke u shpopulluar në formën më të përsorur si frut i këtij diskriminimi.

Ankuesit kërkojnë që Bashkia Berat të vihet para përgjegjësisë për të ndërtuar rrugët e fshatrave të Njësisë Administrative Sinjë me mjetet dhe buxhetin e kësaj bashkie dhe përgjegjësit të mbajnë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara ndaj banorëve të këtyre fshatrave.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të shprehur shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ankuesit “*gjendja ekonomike*”, “*gjendja arsimore*” dhe “*vendbanimi*”. Në nenin 1, të LMD përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës u konstatua se, fillimisht ankesa është paraqitur nga një person dhe konkretisht znj. A.H. Në kuadër të shqyrtimit paraprak të ankesës u konstatua se ankesa ishte me të meta në drejtim të legjitimitetit të znj. Hoxha për të paraqitur ankesën individualisht në kushtet kur ankesa dhe pretendimet e parashtruara në të kanë të bëjnë me interesa kolektive. Për këtë arsye me email datë 24.04.2023, drejtuar znj. A.H është kërkuar pëlqësimi i kësaj ankese me dokumentacionin përkatës.

Në vijim, ankesës iu bashkuan edhe një grup personash banues në fshatin Levan, Njesia Administrative Sinjë, Bashkia Berat, interesat e të cilëve cenohen dhe konkretisht: z. Y.V, znj. L.V, z. A.V, znj. F.V, z. G.D, znj. A.D, z. M.K, znj. Sh.K, z. A.K dhe znj. A.K.

2. Pas plotësimit të ankesës, Komisioneri, në zbatim të parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar ka ndërmarrë hapat si më poshtë për shqyrtimin e saj:

2.1 Me shkresën me nr.449/1 prot., datë 13.06.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga subjektet kunder të cilëve është paraqitur ankesa. Në përgjigje të kërkesës për informacion, me shkresën nr.3151/1 prot datë 26.06.2023, administruar pranë Komisionerit me nr.449/2 prot., datë 29.06.2023, Bashkia Berat ktheu përgjigje duke parashtruar ndër të tjera se:

Nga ana e ankuesve është pretenduar se fëmijëve të disa fshatrave të Njesisë Administrative Sinjë iu është mohuar e drejta për tu arsimuar. Këtë pretendim të tyre ata e lidhin me gjendjen e rrugëve, largësinë e institucioneve shkollore me vendbanimet e tyre dhe me mjetet e transportit që përdoren për fëmijët që frekuentojnë institucionet. Lidhur me këtë pretendim të ankuesve, ju informojmë se:

Njësia Administrative Sinjë, Bashkia Berat përbëhet nga fshatrat si më poshtë:

1. Fshati Levan (417 banorë)
2. Fshati Mbreshtan (887 banorë)
3. Fshati Galinë (430 banorë)
4. Fshati Sadovicë (270 banorë)
5. Fshati Paftal (556 banorë)
6. Fshati Kamçisht (256 banorë)
7. Fshati Mbolan (320 banorë)
8. Fshati Sinjë (324 banorë)
9. Fshati Mbjeshovë (621 banorë)
10. Fshati Velçan (160 banorë)
11. Fshati Osmënzëzë ((E re, E vjetër) (340 banorë)
12. Fshati Plashnik (135 banorë)
13. Fshati Molisht (520 banorë)

Drejtoria e Arsimit, Bashkia Berat ka në administrimin e saj 96 godina të institucioneve arsimore, nga të cilat edhe Shkollën Levan. Nuk rezulton që Drejtoria e Arsimit pranë Bashkisë Berat të ketë në administrim godina për institucione arsimore në fshatrat Mbolan, Velçan dhe Cuke. Theksojmë se, nga banorët e këtyre fshatrave nuk ka patur kërkesa për hapje të institucioneve arsimore parashkollore, sikurse parashikohet në legjislacionin në fuqi, në lidhje me hapjen e institucioneve të reja arsimore.

VKM nr.662, datë 08.10.2014 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike”, pika 3, citohet se: “Nisma për hapjen e një institucioni arsimor parauniversitar publik, ku pritet të hapet institucioni arsimor, përfaqësuesit e tij i paraqesin kërkesë me shkrim kryetarit të bashkisë përkatës të njësisë bazë të qeverisjes vendore dhe titullarit të njësisë përkatëse arsimore vendore”.

Bashkia Berat aktualisht administron objektet e arsimit parashkollor në Njësinë Administrative Sinjë në fshatrat: Mbreshtan, Paftal, Mjeshovë, Molisht, Levan dhe Sinjë.

Në udhëzimin nr.30, datë 12.09.2018, pika 3, citohet: *“Grupet e përziera të nxënësve në zonat rurale të formohen me jo më pak se 10 nxënës që frekuentojnë. Në rastet kur ky numër nxënësish nuk sigurohet, me miratim të njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të formohen grup me jo më pak se 5 nxënës që frekuentojnë”*

Bashkia Berat është njohur me ankesën e znj. A.H etj., për këtë problematikë vetëm pasi është njohur me shkresën tuaj. Banorët e këtyre fshatrave nuk kanë paraqitur kërkesë pranë Bashkisë Berat lidhur me nevojat e tyre për hapjen e institucioneve arsimore parashkollore.

Bashkia Berat, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, në qoftë se do të paraqiten kërkesa për hapjen e institucioneve arsimore, do të marrë në shqyrtim dhe do të trajtojë në mënyrë ligjore mundësinë e hapjes së institucioneve arsimore në këto fshatra.

Në lidhje me pretendimin e ankuesve, për sa i përket transportit të fëmijëve për ndjekjen e arsimit, ju informojmë se nuk është në kompetencat ligjore të Drejtorisë së Arsimit, Bashkia Berat, ofrimi i këtij shërbimi, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar, në ligjin nr.69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. Ky shërbim rregullohet dhe administrohet nga Zyra Vendore e Arsimit Berat, duke përfshirë edhe distancat e kërkuara.

Për sa i përket pikës 3, të shkresës suaj *“Informacion në lidhje me numrin e fëmijëve që ndjekin arsimin parauniversitar të ndara sipas fshatrave që janë pjesë e Njesisë Administrative Sinjë”*, si më poshtë:

Nr.	Institucioni arsimor	Numri i fëmijëve
1	Kopshti Mbreshtan	11
2	Kopshti Paftal	15
3	Kopshti Molisht	10
4	Kopshti Mbjeshovë	10
	Kopshti Sinjë	17

Për të qartësuar shtrirjen e Njësive Administrative të Bashkisë Berat:

Lagjet e qytetit Berat me sipërfaqe 19 km, Njësia Administrative Otlak me sipërfaqe 52.7 km², Njësia Administrative Velabisht me sipërfaqe 93.2 km², Njësia Administrative Sinjë me sipërfaqe 138.5 km², Njësia Administrative Roshnik me sipërfaqe 78.7 km².

Njësia Administrative Otlak është e përbërë nga 10 fshatra, Njësia Administrative Velabisht është e përbërë nga 13 fshatra, Njësia Administrative Sinjë është e përbërë nga 14 fshatra, Njësia Administrative Roshnik është e përbërë nga 13 fshatra.

Bashkia Berat ndër institucionet që ka në varësi është edhe Agjencia e Shërbimeve Publike e përbërë nga 4 sektorë si: Sektori i Mirëmbajtjes së Rrugëve, Sektori i Ndriçimit, Sektori i Gjelbërimit dhe Pastrimit, Sektori i Varrezave Publike, Sektori Mekanik dhe Transportit.

Sektori i mirëmbajtjes së rrugëve në detyrat funksionale ka edhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike dhe ka në përbërjen e saj 31 punonjës për mirëmbajtjen e rrugëve.

Në vitin 2015 me riorganizimin e ri të pushtetit vendor, pas përfundimit të ekzistencës së Komunave dhe transferimin e tyre në Bashkinë e Beratit kemi mbartur edhe shumë problematika në infrastrukturën rrugore.

Agjencia e Shërbimeve Publike në buxhetet e saj për vitet 2015-2023 të miratuar nga Këshilli Bashkiak Berat nuk ka patur fonde për investime në rrjetin rrugor.

Gjendja e trashëguar e rrjetit rrugor të Njësive Administrative, por edhe e qytetit të Beratit ka qenë shumë e amortizuar pasi nuk ka patur ndërhyrje në mirëmbajtje prej shumë vitesh dhe planifikimi për investime në infrastrukturën rrugore kërkonte fonde shumë të larta, të papërballeshme për të ardhurat e bashkisë dhe fondet e buxhetit të Agjencisë së Shërbimeve Publike.

Nga viti 2015-2023 Agjencia e Shërbimeve Publike në buxhetet e miratuara ka patur vetëm fonde për mirëmbajtje të përgjithshme, që konsistojnë në mirëmbajtje rutinë dhe periodike e infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale. Monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjëndjes së infrastrukturës rrugore, sigurimi i mjeteve dhe bazës materiale për pastrim kanali, mbushjes së gropave me çakull, beton ose asfalt dhe kanë qenë të pamjaftueshme për të zgjidhur shumë problematika në çdo Njësi Administrative dhe qytetit të Beratit.

Agjencia e Shërbimeve Publike gjithmonë është e gatshme dhe e prirur për të zgjidhur çdo ankesë dhe problematikë të çdo banori të qytetit të Beratit të koordinuara me plane pune me çdo Administrator Lagje dhe Njësie Administrative në zbatim të detyrave funksionale të institucionit dhe në zbatim të buxheteve të miratuara nga Këshilli Bashkiak Berat.

Gjatësia totale e rrugëve në të gjithë territorin e Bashkisë Berat është 857 km, ndër të cilat 615 km janë rrugët rurale dhe 242 km janë rrugët urbane. Sipërfaqja totale e rrugëve është 857 323 m² në të gjithë territorin e Bashkisë, nga të cilat janë të trajtuara me asfalt 2800 m² dhe me stabilizant 4200 m². Gjatësia totale e rrugëve është 857 km në të gjithë territorin e Bashkisë nga të cilat 615 km janë me çakull dhe me asfalt 242 km.

Mirëmbajtja e rrugëve rurale me çakull në Njësitë Administrative Berat dhe qytet:

Rruga Rabjak-Karkanjoz, Rruga Levan – Sinjë, rruga Kamçisht- Paftal, rruga Velabisht – Palikësht, Mbreshtan (Pastrim gurësh të rëna), rruga Mbreshtan – Paftal, Sinjë (Pastrim gurësh të rëna), rruga Velabisht-Gjoroven-Velesnjë-Molisht, Roshnik i Vogël Qafa e Pazgjanit, Rruga Velabisht-Starovë, Remanicë, Veterik (pastrim kanalesh, pastrim bankinash), rrugë të brendshme të fshatit Orizaj-, rrugë të brendshme të fshatit Otlak, rrugë të brendshme Moravë rruga Hatillarëve), rruga Dushnik-Qereshnik, sheshet që janë mirëmbajtur: kalldrëmi, barërat, kanalet anësore, trotuaret, etj.

Në fshatin Mbolan tek Spitali është sistemuar një pjesë e madhe e rrëshkitur me një volum prej 60 m³ gurë kave dhe 20 m³ çakull.

Mirëmbajtje e rrugëve me çakull:

Mirëmbajtje e rrugëve me çakull, në lagjen Uznovë në rajonin Nr.1, rrugët e lagjeve.

Në rrugët rurale të Njësive Administrative janë kryer këto punime si më poshtë:

- Në fshat, Levan, Mbolan, Velçan janë skarikuar dhe mbushur me çakull.
- Në Otlak skarikuar dhe mbushur me çakull.
- Në Roshnik skarikuar dhe mbushur me çakull.
- Në Moravë skarikuar dhe mbushur me çakull.
- Në Mbjeshevë skarikuar dhe mbushur me çakull.
- Në Njësine Velabisht janë shtruar me çakull.
- Në rrugën Velabisht-Molisht
- Në rrugën Velçan Osmënzëzë, Plashnik çakull.
- Në rrugën Sadovic Kisha e Paftalit.
- Në rrugën Zeqallarët në Duhanas çakull.
- Në fshatin Karkanjoz çakull.
- Fshati Vojnik shtrim rrugë me çakull.
- Fshati Roshnik me çakull.
- Në fshatin Korçë Njësia Administrative Roshnik janë shtruar me gurë kave dhe çakëll mbeturinë.

Shtrim rrugë me beton:

- Rruga Partizani Velabisht shtrim me beton.
- Në Palikësh shtrim me beton.
- Në lagjen Çlirim shtrim me beton

Shtrim rrugë me asfalt:

- Në lagjen 22 Tetori është sistemuar me asfalt.
- Në rrugën e Ushqimores është sistemuar me asfalt.
- Rruga Sulo Resuli është sistemuar me asfalt.
- Lagjen Çlirim është sistemuar me asfalt.
- Rruga MCR është sistemuar me asfalt.
- Fshati Mimias është sistemuar me asfalt.
- Në rrugën Pyjore është sistemuar me asfalt.
- Në rrugën Kanaij është sistemuar me asfalt.

Në rrugët rurale të Njësive Administrative janë kryer këto punime si më poshtë:

Shtrim rruge me beton:

- Në fshatin Lapardha rrugë betoni.
- Në fshatin Drobonik rrugë betoni.
- Në fshatin Veleshnje rrugë betoni.
- Në fshatin Kamçisht rrugë betoni.

Përfundimisht, theksojmë se, nga ana e Bashkisë Berat dhe institucioneve në varësi të saj nuk ka patur asnjë shenjë diskriminimi ndaj banorëve të fshatrave që përmenden, në asnjë prej formave të parashikuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

3. Informacioni i dërguar nga Bashkia Berat, i është komunikuar palës ankuese, sipas email të datës 10.07.2023. Nëpërmjet emailit datë 11.7.2023, pala ankuese ka dëguar kundërshtimet e mëposhtme:

Përgjigja e Bashkisë Berat (letra e datës 26.6.2023 nr.prot. 3151/1) nuk është e plotë dhe midis të tjera për këto arsye:

Pushteti vendor, Kryeplaku i Fshatit, Drejtoria e Rrugëve dhe Kryetari janë njohur me kërkesën e këtyre banorëve në vitin 2021 (janë njoftuar për mirëmbajtjen urgjente të rrugës në segmentin e humnerës në lagjen Vahaj dhe Kullsat (50-80 m rrugë). Pushteti qendror është njohur me kërkesën e banorëve për nevojën e një ndërhyrje emergjente në disa segmente të rrugës (humnerës në lagjen Vahaj dhe Kullsat (50-80 m rrugë). Bashkëqeverisja ia ka komunikuar këtë ankesë Bashkisë Berat.

Nuk paraqitet në përgjigje numri i fëmijëve që ndjekin arsimin parauniversitar. Në përgjigjen e bashkisë pasqyrohet vetëm numri i fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor dhe nuk ka informacion për distancat që fëmijët bëjnë në këmbë. Nuk ka asnjë informacion në lidhje me mbështetjen e aktiviteteve jashtshkollore për këta fëmijë. A ka patur një aktivitet artistike të organizuar nga Bashkia? Sportive? Bibliotekë?

Bashkia mjaftohet me një përmendje të mirëmbajtjes së rrugës Fshati Levan- Sinjë, por nuk jep shpjegim për mënyrën/ditët/materialet e përdorura apo të bashkëlidh dokumentacion. Nuk paraqitet një informacion në lidhje me investimet e bëra nga bashkia në 10 vjetët e fundit. Burimi i fondeve, shuma, kriteret e shpërndarjes dhe shpërndarja faktike. Nuk paraqitet asnjë informacion në lidhje me studimet dhe planifikimin për mirëmbajtjen e rrugëve në Njësinë Administrative Sinjë.

Për vitet 2010-2023, nuk ka asnjë plan pune nga Drejtoria e Rrugëve për mirëmbajtjen e rrugëve të këtyre fshatrave.

4. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr.449/3 prot., datë 18.08.2023, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 31.08.2023 ora 11:00.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesmarrjen e ankuesve, znj. A.H, z. Y.V, z. A.V, z. A.K, ndërsa nuk u paraqitën ankuesit e tjerë. Në seancë mori pjesë z. M.D, Administrator i Njesisë Administrative Sinjë dhe z. R.D, përfaqësues i Agjencisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Berat, sipas autorizimit të datës 29.08.2023, lëshuar nga Drejtori i kësaj Agjencie. Në seancë dëgjimore nuk u paraqitën përfaqësues nga Bashkia Berat dhe Këshilli Bashkiak Berat, të cilët janë njoftuar për të marrë pjesë nëpërmjet shkresës nr. 449.3 prot datë 18.8.2023.

Gjatë seancës dëgjimore pala ankuese vuri theksin se, situata e rrugëve është shumë serioze dhe mosndërrhyrja dhe marrja e masave nga ana e institucioneve është bërë shkak për mos marrjen e shumë shërbimeve nga ana e banorëve që banojnë në fshatin Levan, si mosmarrja e shërbimeve shëndetësore në moment nevojë, mosfrekuentimin e institucioneve të arsimit nga ana e fëmijëve, si dhe shumë problematika të tjera. Shkolla e Bashkuar është në një shpat mali dhe rruga është tepër e rrezikshme për fëmijët. Që nga viti 2018, asnjë nuk është mirëmbajtur. Kemi kontaktuar disa herë me drejtorin e Agjencisë së Shërbimeve Publike, për të bërë të mundur shtrimin e rrugës tek humnera. Mjeti i transportit refuzon t'i marre fëmijët, pasi është e rrezikshme të kalojnë në humnerë. Për shkak të kushteve meteorologjike fëmijët e sëmurë e kanë të pamundur të kalojnë në këmbë. Aktualisht në mes të rrugës ka një kanal të madh. Fëmijët duhet të ecin në këmbë për një orë në mes të pyllit dhe kjo është është akoma më e vështirë për vajzat. Prindërit hezitojnë për ti dërguar vajzat në shkollë pasi ato përfundojnë arsimin e detyrueshëm, pasi e konsiderojnë të rrezikshme që vajzat të udhëtojnë të vetme në mes të pyllit.

Përfaqësuesi i Agjencisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Berat, deklaroi se institucioni që ai përfaqëson mirëmban dhe monitoron rrugën, por nuk bën investime. Ai theksoi se, investimi i fundit është bërë gjatë muajve maj-qershor 2023, ndërhyrje e cila e ka përmirësuar situatën. Rruga Levan-Sinjë është një rrugë e cila ka patur ndërhyrje. Koncepti i infrastrukturës është shumë i gjerë, por vend për përmirësim ka gjithmonë.

Administratori i Njesisë Administrative Sinjë deklaroi se, Drejtoria Arsimore ka vënë në dispozicion një furgon nga Levani në Sinjë. Furgoni nuk ka detyrë të marrë fëmijët në çdo shtëpi. Rruga është në gjëndje të kalueshme dhe ndërhyrja e fundit është bërë në muajin prill. Administratori deklaroi se janë bërë dy herë në çdo vit ndërhyrje në rrugë, të paktën gjatë periudhës që ai ushtron këtë detyrë. Administratori theksoi se, problemi i ankuesve është vetëm se furgoni nuk shkon në çdo shtëpi, por furgoni ka vetëm rrugën kryesore.

5. Me shkresën nr. 449/4 prot., datë 26.09.2023, Komisioneri i është drejtuar me një kërkesë për informacion në lidhje me ndjekjen e arsimit nga fëmijët e fshatit Levan, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë dhe Zyrës

Vendore të Arsimit Parauniversitar Berat (ZVAP Berat). Në përgjigje të kësaj kërkesë për informacion, me shkresën nr.1096/1 prot, datë 06.10.2023, ka kthyer përgjigje ZVAP Berat, në të cilën informon si më poshtë:

Shkolla 9-vjecare “Levan” është në varësi të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Jani Dodi, Sinjë”, e cila është shkollë në funksion të plotë të procesit mësimor edukativ në këtë njësi administrative. Gjatë këtyre viteve dhe për vitin shkollor 2023-2024 shkolla 9-vjecare “Levan” është e hapur dhe funksionon me një numër të vogël nxënësish duke marrë në konsideratë: zonën e largët në të cilën ndodhet, vështirësitë e terrenit, kushtet gjeografike, migrimin dhe emigrimin e banorëve të këtij fshati.

Fëmijët e zonës rurale Levan për vitin shkollor 2023-2024, me dëshirën dhe vullnetin e tyre të plotë janë regjistruar dhe ndjekin procesin mësimor në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Jani Dodi, Sinjë” (qendër). ZVAP Berat është vënë në dijeni nga drejtuesi i IAP mbi vështirësitë e terrenit, kushtet jo të favorshme gjeografike dhe atmosferike me të cilat këta fëmijë përballen gjatë gjithë vitit për frekuentimin e shkollës Levan, për këtë arsye duke marrë në konsideratë edhe grupmoshën e fëmijëve iu është siguruar subvencioni i transportit nga buxheti i shtetit. Për transportin e fëmijëve të zonës rurale Levan ka një linjë të miratuar me destinacion Levan-Sinjë-Levan, e cila ka funksionuar dhe vazhdon të jetë ekzistuese me miratimin sipas linjave nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Berat. Shkolla “Levan” vartëse e SHMB “Jani Dodi, Sinjë” është e hapur, funksionale dhe në shërbim të komunitet, ku për vitin shkollor 2023-2024, i ofrohet shërbim dy nxënësve, përkatësisht në klasën e parë dhe në klasën e pestë të arsimit fillor.

Në Shkollën Levan, për vitin shkollor 2021-2022, ka qenë i regjistruar 1 (një) nxënës me aftësi të kufizuar, për vitin shkollor 2022-2023 ka qenë i regjistruar 1 (një) nxënës me aftësi të kufizuar dhe për vitin shkollor 2023-2024 janë të regjistruar 2 (dy) nxënës në arsimin fillor. Siguria dhe shëndeti janë pjesë të rëndësishme e jetës shkollore dhe nga të gjitha strukturat bëhen përpjekje maksimale për çdo ditë në sigurimin e transportit.

ZVAP Berat ka ndjeshmëri maksimale dhe përpaket të realizojë në kohë dhe pa vonesa rimbursimin e transportit dhe jo vetëm, mbështetjen e këtyre fëmijëve, nxënësve në ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor, në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshm të nxënësit.

6. Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr.6044/3 prot., datë 23.10.2023, ka përcjellë shkresën nr. 1096/1 prot., datë 06.10.2023, të Zyrës Vendore Arsimore Prauniversitar Berat, me informacionin e sipërcituar.

DRAP Korçë nuk ktheu përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion të Komisionerit.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Ankuesit që kanë paraqitur ankesën objekt shqyrtimi së bashku me familjet e tyre, janë banorë të fshatit Levan, Njësia Administrative Sinjë, në Bashkinë Berat, fakt ky që rezulton i provuar në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Kryeplaku i fshatit Levan.

Në ankesën e paraqitur ankuesit pretendojnë se për shkak të mungesës së rrugëve të sigurta dhe të kalueshme, fëmijët e fshatrave Mbolan, Levan, Velcan dhe Cuke, iu mohet dhe shkelet e drejta e jetës, e drejta për t'u arsimuar. Komisioneri vlerëson se, grupi i ankuesve të cilët janë të gjithë banorë të fshatit Levan, nuk legjitimohen për të ngritur pretendime në lidhje me fshatrat e tjerë përveç, pretendimeve që kanë të bëjnë me situatën e fshatit Levan.

Ankuesit pretendojnë se, në mënyrë që fëmijët e fshatit të edukohen nga arsimi parashkollor deri në mbarim të shkollës së mesme, duhet të shkojnë në qendrën e Njesisë Administrative Sinjë, ku ndodhet Shkolla e Mesme e Bashkuar “Jani Dodi, Sinjë”, e cila ndodhet larg shtëpive të tyre me kilometra. Ankuesit pretendojnë se, rrugët e fshatit nuk mirëmbahen nga Bashkia Berat dhe për këtë arsye ato nuk janë të kalueshme për mjetet e transportit për të bërë të mundur transportin e fëmijëve të fshatit për në Shkollën e Bashkuar “Jani Dodi, Sinjë”. Për shkak se mjetet e transportit nuk mund të kalojnë në rrugët e fshatit, fëmijët duhet të ecin në këmbë rreth një orë, në rrugë të vështirë dhe të rrezikshme. Në mënyrë të veçantë ankuesit ngrenë shqëtesimin për një pjesë të rrugës në lagjen Vahaj –Kullsat me një gjatësi rreth 50-80 m ku për shkak të humnerës rruga është shumë e rrezikshme dhe kërkon mirëmbajtje urgjente.

Gjatë periudhës së dimrit për shkak të kushteve metereologjike dhe terrenit të vështirë malor fëmijët e kanë të vështirë ose pothuajse të pamundur të shkojnë në shkollë për shkak se rruga është e pakalueshme. Fëmijët të cilët kanë probleme shëndetësore ose fëmijët me aftësi të kufizuara e kanë të pamundur që të përshkruajnë në këmbë një distancë të tillë. Ankuesit theksojnë se, furgoni i vendosur në dispozicion për transportin e fëmijëve për në shkollë i merr fëmijët në qëndër të fshatit aty ku ndodhet shkolla, por gjatë periudhës së dimrit edhe mjeti i transportit e ka të pamundur të transportojë fëmijët për shkak të humnerës që ndodhet në rrugën e lagjes Vahaj-Kullsat.

Ankuesit kanë paraqitur ankesën objekt shqyrtimi kundër Bashkisë Berat, Këshillit Bashkiak Berat, Administratorit të Njesisë Administrative Sinjë dhe Drejtorisë së Mirëmbajtjes së Rrugëve, duke pretenduar diskriminimin e fëmijëve banorë të fshatit Levan, Njësia Administrative Levan, Bashkia Berat për shkak të gjendjes arsimore, gjendjes ekonomike dhe vendbanimit.

Neni 23, i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Në këtë nen parashikohet se:

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

- 1.Prodhimin,trajtimin,transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.*
- 2.Mbledhjen,largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.*
- 3.Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.*
- 4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.*
- 5.Ndriçimin e mjediseve publike.*
- 6.Transportin publik vendor.*
- 7. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.*
- 8 .Shërbimin e dekorit publik.*
- 9.Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.*
- 10.Mbledhjen,largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.*
- 11. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.*
- 12.Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.*
- 13.Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*
- 14.Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*

Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Berat është përgjegjëse në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në territorin e juridiksionit të saj. Përgjegjësitë e saj lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me, ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve në fshatin Levan në Njësinë Administrative Sinjë, që është pjesë e juridiksionit të kësaj bashkie.

Bazuar në informacionin e administruar gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se, fshati Levan, është pjesë e Njësisë Administrative Sinjë, në Bashkinë Berat. Njësia Administrative Sinjë ka një sipërfaqe 138.5 km² dhe është e përbërë nga 13 fshatra, ku njëri prej tyre është fshati Levan, banorë të të cilit janë ankuesit. Fshati Levan, sipas të dhënave të Bashkisë Berat ka 417 banorë. Njësia Administrative Sinjë ka sipërfaqen më të madhe të të gjitha Njësisë Administrative të Bashkisë Berat, por kjo nuk shoqërohet në përpjestim të drejtë me numrin e banorëve.

Në referim të nenit 23 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Bashkia Berat është përgjegjëse për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale, si dhe

për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe, në territorin në juridiksionin e saj.

Në referim të pikës 1, të nenit 28, të ligjit nr.69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, Bashkia Berat, në cilësinë e njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore, ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në këtë drejtim, sipas pikës 2, të po kësaj dispozite ligjore, kompetencat kryesore të njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore, në rastin objekt shqyrtimi, të Bashkisë Berat janë:

- a) ndërtimi dhe rikonstruksioni i godinave të institucioneve arsimore publike, sipas standardeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me fonde të Buxhetit të Shtetit ose me fonde nga transfertat e pakushtëzuar ose të ardhurat e veta;*
- b) garantimi i paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe i mjediseve të tyre;*
- c) ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik;*
- ç) garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike.*
- d) planifikimin e nevojave për ndërtimin dhe rikonstruksionin e godinave të institucioneve arsimore parauniversitare pas marrjes së mendimit të ministrisë përgjegjëse për arsimin për planifikimin dhe shpërndarjen e nxënësve në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.*

Sipas pikës 3 dhe 4, të dispozitës së sipërcituar, përcaktohet se:

3. Njësia bazë e vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë.

4. Njësia bazë e vetëqeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësive vendore, mbështet:

- a) nxënësit e familjeve në nevojë;*
- b) nxënësit me arritje të shkëlqyera;*
- c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës*

Sa më sipër rezulton se njësitet e vetëqeverisjes vendore kanë një rol shumë të rëndësishëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit që banojnë në territorin nën juridiksionin e tyre.

Bashkia Berat informon se ka në administrimin e saj 96 godina të institucioneve arsimore, nga të cilat edhe Shkollën Levan. Sipas ZVAP Berat Shkolla Levan, e cila është shkollë vartëse e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Jani Dodi, Sinjë” është një shkollë në funksion të plotë të procesit mësimor edukativ. Gjatë këtyre viteve Shkolla 9-vjeçare Levan, ka qenë e hapur dhe në funksion dhe vazhdon të jetë edhe përgjatë vitit 2023-2024. Kjo shkollë sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga ZVAP Berat ka funksionuar dhe funksionon me një numër të vogël nxënësish për shkak të se ndodhet në një zonë të largët, terrenit të vështirë, kushteve gjeografike, migrimit dhe emigrimit të banorëve të këtij fshati.

ZVAP Berat informon se, në shkollën 9-vjeçare Levan, përgjatë dy viteve shkollore, 2021-2022 dhe 2022-2023, ka qenë i regjistruar vetëm një nxënës, i cili ka qenë me aftësi të kufizuara. Për vitin mësimor 2023-2024, në shkollë janë regjistruar dy nxënës në arsimin fillor, përkatësisht në klasën e parë dhe klasën e pestë të arsimit fillor.

Nga informacioni i vendosur në dispozicion nga Bashkia Berat rezulton se, në fshatin Levan nuk ka një institucion të arsimit parashkollor, kopësht. Në Njësinë Administrative Sinjë institucione të arsimit parashkollor/kopshte gjenden vetëm në fshatrat Mbreshtan, Paftal, Molisht, Mbjeshevë dhe Sinjë.

Bashkia Berat, por edhe ZVAP Berat nuk dhanë informacion në lidhje me gjendjen dhe kushtet e Shkollës 9-vjeçare Levan. Ndërsa ankuesit pretendojnë se, për të ndjekur shkollën fëmijët duhet të shkojnë në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Jani Dodi, Sinjë”, ZVAP Berat informoi se Shkolla 9 vjeçare Levan ka qenë funksionale dhe vazhonte të ishte e hapur edhe përgjatë vitit arsimor 2023-2024. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, rezulton se në Shkollën 9 vjeçare Levan, për vitin shkollor 2023-2024, janë të regjistruar dy nxënës që ndjekin arsimin fillor.

Plan Buxheti 2023 dhe PBA Përfundimtare 2023-2025, të publikuara *online* në faqen zyrtare të Bashkisë Berat³, lidhur me problematikat e institucioneve arsimore, sipas studimit të nevojave, në lidhje me Shkollën Levan, konstatohet se: *“Shkolla është e amortizuar, përbëhet vetëm nga një klasë e bashkuar e cila mirëmbahet”*.

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Bashkia Berat, rezulton se gjatësia totale e rrugëve në të gjithë territorin e kësaj bashkie është 857 km, nga të cilat 615 km janë rrugë rurale dhe 242 km janë rrugë urbane. Gjithashtu rezulton se, nga gjatësia totale e rrugëve prej 857 km, 615 km janë me çakull dhe 242 janë të shtruara me asfalt

Bashkia Berat parashtrroi gjatë shqyrtimit të ankesës së, kanë mbartur shumë problematika në infrastrukturën rrugore, me riorganizimin e ri të pushtetit vendor në vitin 2015 dhe pas transferimit të komunave tek bashkia. Bashkia deklaroi se, gjendja e trashëguar e rrjetit rrugor të Njësi Administrative, por edhe e qytetit të Beratit, ka qenë shumë e amortizuar. Planifikimi për investime në infrastrukturën rrugore kërkonte fonde shumë të larta, të papërbalueshme për të ardhurat e bashkisë. Agjencia e Shërbimeve Publike, Bashkia Berat e cila është përgjegjëse për infrastrukturën rrugore në buxhetet e saj për vitet 2015-2023 të miratuar nga Këshilli

³ <https://bashkiaberat.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/Buxheti-2023-2025.pdf>

Bashkiak Berat, nuk ka patur fonde për investime në rrjetin rrugor. Gjatë këtyre viteve në buxhetet e miratuara Agjencia e Shërbimeve Publike ka patur vetëm fonde për mirëmbajtje të përgjithshme, që konsistojnë në mirëmbajtje rutinë dhe periodike të infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale, si monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjëndjes së infrastrukturës rrugore, sigurimi i mjeteve dhe bazës materiale për pastrim kanali, mbushjes së gropave me çakull, beton ose asfalt, duke pranuar se kanë qenë të pamjaftueshme për të zgjidhur shumë problematika në çdo Njësi Administrative dhe qytetit të Beratit.

Bashkia Berat informoi se, ka kryer mirëmbajtjen e rrugëve rurale me çakull në disa njësi administrative dhe në qytet, ku përfshihet rruga Levan-Sinjë, sikurse pasqyrohen në informacionin e dërguar nga Bashkia Berat. Bashkia Berat deklaroi gjithashtu se, në rrugët rurale të Njësisë Administrative janë kryer punime si skarikim dhe mbushje me çakull, përfshirë fshatin Levan, si dhe fshatrat të tjerë sikurse pasqyrohen në informacionin e dërguar nga Bashkia Berat, si dhe ka realizuar shtrimin e disa rrugëve me beton dhe ka bërë sistemime me asfalt në disa rrugë.

Bashkia Berat nuk vendosi në dispozicion informacionin provues në lidhje me kryerjen e këtyre punimeve mirëmbajtëse dhe periudhën se kur janë realizuar. Referuar parashtrimeve të Bashkisë Berat, ajo i referohet periudhës 2015-2023, por pa dhënë informacion të saktë në lidhje me periudhën kohore kur janë kryer punimet dhe sistemimet në rrugët, të pretenduara nga ana e saj.

Gjatë seancës dëgjimore, Administratori i Njësisë Administrative Sinjë dhe përfaqësuesi i Agjencisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Berat, deklaruan se pavarësisht problematikave rruga ishte e kalueshme dhe nuk paraqiste rrezikshmëri.

Ankuesit pretendojnë se, në segmentin rrugor në lagjen Vahaj dhe Kullsat, rreth 50-80 m rrugë, rruga ka rrëshkitur duke krijuar një humnerë, duke paraqitur rrezikshmëri për transportin e furgonit që transporton fëmijët nga qendra e fshatit Levan për në Shkollën e Mesme të Bashkuar Jani Dodi, Sinjë. Gjatë periudhës së dimrit, për shkak të kushteve të motit dhe terrenit të vështirë kjo pjesë e rrugës bëhet e pakalueshme dhe furgoni që kryen transportin e fëmijëve për në shkollë nuk e përshkon këtë rrugë dhe në këtë mënyrë fëmijët mbeten pa shkollë. Gjithashtu ankuesit pretendojnë se, midis vendit ku mjeti grumbullon fëmijët për ti transportuar në shkollë, që është te qendra e fshatit në afërsi të shkollës Levan dhe shtëpive të fëmijëve ka një ditancë të madhe dhe fëmijëve ju duhet të ecin për rreth një orë në këmbë. Kjo distancë që duhet të përshkruhet në këmbë nga fëmijët shoqërohet me vështirësi të shtuar për shkak të terrenit të vështirë dhe rrugës së keqe, që gjatë periudhës së dimrit bëhet e pakalueshme në këmbë nga fëmijët, e veçanërisht fëmijët e vegjël apo fëmijët me aftësi të kufizuar.

Një tjetër problematikë e ngritur nga ankuesit, ka të bëjë me ndjekjen e shkollës nga vajzat. Për shkak të gjëndjes së rrugës dhe distancës, ankuesit ngrenë shqetësimin në lidhje me sigurinë e vajzave dhe ndjekjen e arsimit të mesëm nga ana e tyre. Sipas ankuesve, për shkak të mungesës së rrugës dhe shqetësimit për sigurinë e vajzave, prindërit vendosin edhe pse kjo nuk është dëshira e tyre, që të mos i çojnë vajzat për të ndjekur gjimnazin.

Në mbështetje të pretendimeve të tyre ankuesit depozituan pamje fotografike dhe video të rrugëve të fshatit si dhe segmentit rrugor ku rruga ka rrëshqitur dhe ku është edhe problematika më e madhe.

Nga shqyrtimi i këtyre pamjeve, konstatohet se gjendja e rrugëve është në kushte shumë të vështira dhe përshkrimi i distancave në këmbë nga ana e fëmijëve, veçanërisht në rastin e fëmijëve me aftësi të kufizuar, dukshëm paraqet vështirësi ose pamundësi.

Administratori i Njesisë Administrative Sinjë dhe përfaqësuesi i Agjencisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Berat, edhe pse pretenduar se pavarësisht problematikave rruga ishte e kalueshme, përballë pretendimeve të ankuese të cilët ngrenë shqetësimin dhe jetojnë çdo ditë me situatën e rrugëve, nuk paraqitën asnjë vlerësim apo analizë, të kryer nga persona përgjegjës dhe ekspertë për sigurinë e rrugëve për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesve.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, pala ankuese kërkoi nga Komisioneri që të administronte dy emisione të transmetuara në media në lidhje me problematikën e ngritur në ankesë dhe konkretisht, njëri në emision investigativ Fiks Fare, të transmetuar në datën 16.11.2023 në televizionin Top Chanel dhe tjetri publikuar *online* nga Citizzen Chanel.

Komisioneri kreu verifikimet në lidhje me sa më sipër dhe administroi materialet përkatëse të transmetuara nga Televizioni Kombëtar Top Chanel, në emisionin investigative Fiks Fare të datës 16.11.2023⁴ dhe materialin dhe videot e publikuara online në platformën *online* Citizzen Chanel⁵.

Nga shqyrtimi i materialeve të transmetuara në mediat e mësipërme, konstatohet e njëjta situatë me provat e depozituara nga pala ankuese. Sipas informacionit të transmetuar në media konstatohet se, për shkak të kufizimit fizik nxënësja A.B, e cila ishte regjistruar për vitin shkollor 2023-2024 për të ndjekur në klasën e 10, në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Jani Dodi, Sinjë” nuk mund të vazhdonte të ndiqte mësimin në shkollë për shkak se e kishte të pamundur për shkak të gjendjes së saj fizike që të bënte në këmbë distancën nga shtëpia e saj për në vendin ku mjeti i vendosur në dispozicion bën transportin e nxënësve për në shkollë. Familjarët e një tjetër nxënëse, e cila gjithashtu duhet të ndiqte klasën e 10, ngrinin shqetësimin se vajza nuk mund të vazhdonte shkollën pasi për shkak të mungesës së rrugës dhe terrenit të vështirë, ata ishin të shqetësuar për sigurinë e saj.

Justifikimi i Bashkisë Berat në lidhje me gjendjen e infrastrukturës rugore, konstiston në faktin e problematikave të shumta të mbartuara në lidhje me gjendjen e rrugëve para riorganizimit të pushtetit vendor në vitin 2015 dhe në faktin se, planifikimi për investime në infrastrukturën rugore kërkon fonde shumë të larta, të cilat janë të papërballueshme për të ardhurat e bashkisë. Bashkia Berat nuk vendosi në dispozicion dokumentacionin përkatës provues në lidhje me punimet konkrete që janë kryer dhe periudhën kohore se kur janë kryer punimet mirëmbajtëse

⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=w5Egily72ro>

⁵ <https://citizens-channel.com/2023/10/23/pa-rruge-pa-uje-pa-shkolle-fshati-i-harruar-i-beratit/>
<https://www.youtube.com/watch?v=VGWULxDF7A8&t=81s>

në lidhje me rrugët e pretenduara. Rezulton se, për vitet 2015-2023 në rrugët e fshatit Levan janë kryer vetëm dy ndërhyrje, një në rrugën Levan –Sinjë dhe një tjetër ku deklarohen punimet skarikim dhe mbushje me çakull në fshatin Levan, por pa specifikime të mëtejshme në lidhje me rrugët konkrete të fshatit ku janë kryer këto punime. Situata e konstatuar e rrugëve, tregon se, gjithashtu ka munguar monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjëndjes së infrastrukturës rrugore.

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se fëmijët e fshatit Levan, Njësia Administrative Sinjë, Bashkia Berat, i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e Bashkisë Berat, pasi infrastruktura e papërshtatshme/rrezikshme rrugore cenon të drejtën e tyre për arsim.

B. Shkak i mbrojtur.

Ankuesit pretendojnë diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike*” dhe “*gjendjes arsimore*” dhe “vendbanimit”.

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë *në radhë të parë* se shkak i pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe *në radhë të dytë* duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

Komisioneri konstaton se, shkaqet e pretenduara “*gjendja ekonomike*”, “*gjendja arsimore*” dhe “*vendbanimi*” parashikohen shprehimisht si shkaqe të mbrojtura nga neni 1, i LMD dhe rrjedhimisht ato gëzojnë mbrojtje nga diskriminimi.

Në lidhje me provueshmërinë e shkakut të “*gjendjes ekonomike*” dhe “*gjendjes arsimore*”, gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administruan prova në lidhje me këto dy shkaqe dhe rrjedhimisht Komisioneri vlerëson si të pabazuar pretendimin për diskriminim bazuar në shkakun e gjendjes arsimore dhe gjendjes ekonomike.

Në lidhje me shkakun e vendbanimit, ankuesit pretendojnë se situata diskriminuese ka ardhur për shkak se ata banojnë në një zonë të thellë rurale. Bazuar në informacionin e administruar rezultoi e provuar se ankuesit janë banorë të fshatit Levan, Njësia Administrative Sinjë, Bashkia Berat dhe se fshati gjendet në një zonë të thellë dhe me një terren të vështirë. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e “vendbanimit”.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe disfavorizues me shkakun e mbrojtur, vendbanimi.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon : *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.”*

E drejta për arsimim është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këtë dispozitë Kushtetuese sanksionohet se: *“1. Kushdo ka të drejtën për arsimim. 2. Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj. 3. Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë. 4. Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie. 5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas”*

Në nenin 15, të saj Kushtetuta sanksionon se: *“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.”*

Neni 1, i ligjit nr.69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, parashikon: *“1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. 2. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i së drejtës kushtetuese për arsimim, sipas kuadrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar.....”*, ndërsa neni 5, i këtij ligji sanksionon: *“1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar. 2. Në shkollat publike arsimi i detyrueshëm dhe arsimi i mesëm i lartë janë falas.”*

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendim nr. 31 datë 04.10.2021)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj*

të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përligjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁶. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁷.

LMD, i cili është legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi garanton mbrojtje nga diskriminimi si në fushën e arsimit ashtu edhe në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Konkretisht nenet 17 dhe 20, të LMD sanksionojnë:

“Neni 17

Ndalimi i diskriminimit

⁶ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁷ Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

1. *Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:*
 - a) *krijimin e institucioneve publike ose private që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;*
 - b) *financimin e institucioneve publike që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;*
 - c) *përmbajtjen e parimeve dhe kritereve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies;*
 - ç) *trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.*

Neni 20

Të mirat dhe shërbimet

1. *Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:*
 - a) *duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
 - b) *duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet: “*“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD, ku parashikohet se : “*7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.*” I njëjti rregullim në lidhje me barrën e provës, parashikohet edhe në nenin 82, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se: “*2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet*

të provojë se faktet nuk përbejnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.⁸

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të administruara përgjatë hetimit administrativ, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka vlerësuar se fëmijët e fshatit Levan, Njësia Administrative Sinjë, Bashkia Berat, i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e Bashkisë Berat, pasi infrastruktura e papërshtatshme/rrezikshme rrugore cenon të drejtën e tyre për arsim.

Bazuar në tërësinë e provave dhe informacionit të administruar, rezulton se Bashkia Berat, me pretendimin e mungesës së fondeve nuk ka kryer investime në infrastrukturën rrugore, si në atë urbane ashtu edhe në atë rurale, por ka kryer vetëm shërbime për mirëmbajtje të përgjithshme, që konsistojnë në mirëmbajtje rutinë dhe periodike të infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale. Rezulton se Bashkia Berat ka kryer dy ndërhyrje në rrugët në fshatin Levan, të cilat bazuar në konstatimet e bëra gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultojnë të pamjaftueshme.

Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administruan prova apo të dhëna në lidhje me ekzistencën e një difference në shpërndarjen e fondeve për kryerjen e investimeve apo shërbimeve të përgjithshme në lidhje me mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe atyre rurale. Komisioneri nuk mund të vlerësojë në lidhje me pamjaftueshmërinë e fondeve për investime në infrastrukturën rrugore urbane dhe rurale nga ana e Bashkisë Berat, por nëse ka ndonjë diferencë të trajtim dhe në shpërndarjen e fondeve midis zonave urbane dhe atyre rurale.

Nga informacioni i administruar rezulton se, mungesa e investimeve vërehet edhe në zona të tjera të bashkisë dhe për këtë arsye mungesa e investimeve nuk mund të lidhet me vendbanimin. Pra, konstatohet se, Bashkia Berat nuk ka kryer investime edhe në zonat urbane dhe rrjedhimisht, në bazë të informacionit të administruar nuk mund të bëhet lidhja midis mungesës së investimeve dhe faktit që kemi të bëjmë me një zonë rurale.

⁸ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

Gjithë sa më sipër, pavarësisht konstatimit të trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm ndaj fëmijëve të fshatit Levan, Njësia Administrative Sinjë dhe ekzistencës së shkakut të mbrojtur “vendbanimit”, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të krijuar prezumimin se trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm ka si shkak vendbanimin.

Konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe ekzistenca e shkakut të mbrojtur të diskriminimit, nuk mund të çojnë *a priori* në përfundimin se jemi përpara një sjellje diskriminuese, për sa kohë që nuk mund të prezumohet lidhja shkakësore, pra se arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji. Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim, pasi për t’u konsideruar i tillë duhet të lidhet domosdoshmërisht me një shkak të mbrojtur të LMD-së.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, bazuar në provat dhe informacionin e administruar nuk mund të arrihet në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe disfavorizues ka ardhur për shkak të të vendbanimit, dhe rrjedhimisht nuk konstaton shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Personat të cilët jetojnë në zona rurale janë në një situatë më të disavantazhuar se personat që jetojnë në zonat urbane dhe rrjedhimisht ata kanë më tepër gjasa që të jenë viktima të diskriminimit. Organet monitoruese të disa konventave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara si, Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar si dhe Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në konkluzionet e tyre përfundimtare në kuadër të raportimeve të bëra nga ana e Shqipërisë për zbatimin e Konventave të monitoruara prej këtyre organizmave, kanë theksuar nevojën për një vëmendje të shtuar ndaj grupeve të disavantazuara që jetojnë në zonat rurale. Vulnerabiliteti i shumfishtë i personave që jetojnë në zonat rurale, i ekspozon ata ndaj një situate akoma më të vështirë dhe një diskriminimi ndërsektorial. Ndërveprimi i faktit që një person jeton në një zonë rurale, me faktorë të tjerë si gjinia apo aftësia e kufizuar, e ekspozon personin ndaj një situate akoma më të vështirë.

LMD në pikat 3 dhe 5, të nenit 3 të tij sanksionon: “3. “*Diskriminim ndërsektorial*” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyre të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit.5. “*Diskriminim i shumfishtë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe që veprojnë veçmas”, ndërsa në nenin 3/1 të tij parashikon format e rënda të diskriminimit, duke përcaktuar : “Çdo sjellje diskriminuese që është motivuar nga më shumë se një shkak, kur është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose kur ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën përbën formë të rëndë të diskriminimit.”

Bazuar në nenin 21 të LMD, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Bazuar në misionin e tij, si dhe në referim të nenit 32, pika 1, germa “f”, të LMD, ku përcaktohet se, *Komisioneri ka kompetencë të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin*, Komisioneri, me qëllim parandalimin e situata diskriminuese, jo vetëm për shkak të vendbanimit, por edhe për të adresuar ndërveprimin e shkaqeve të tjera të diskriminimit si gjinia, aftësia e kufizuar apo mosha, por jo vetëm, të cilat mund të gjenerojnë forma të diskriminimit ndërsektorial, të diskriminimit të shumfishtë, apo forma të rënda diskriminimi, rekomandon, Bashkinë Berat që të marrë masa të menjëhershme për të mirëmbajtur dhe rregulluar segmentin rrugor në lagjen Vahaj dhe Kullsat (humnera), në fshatin Levan, ku për shkak të rrëshkitjes, rruga është bërë e rrezikshme, si dhe të trajtojë me prioritet mirëmbajtjen dhe rregullimin e rrugëve në këtë fshat.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 e 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të fëmijëve të fshatit Levan, Njësia Administrative Sinjë, për shkaqet e pretenduara “*gjendja ekonomike*”, “*gjendja arsimore*” dhe “*vendbanimi*” nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa.
2. Me qëllim marrjen e masave për të parandaluar në të ardhmen situata të mundshme diskriminuese, Komisioneri rekomandon Bashkinë Berat që të marrë *masa të menjëhershme* për të mirëmbajtur dhe rregulluar rrugën në segmentin në lagjen Vahaj dhe Kullsat, në fshatin Levan, Njësia Administrative Sinjë, ku për shkak të rrëshkitjes rruga është bërë e rrezikshme, si dhe të planifikojë dhe të zbatojë me prioritet mirëmbajtjen dhe rregullimin e rrugëve në këtë fshat, brenda vitit 2024.
3. Bashkia Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimit.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Shkaku: Vendbanimi, gjendja ekonomike, gjendja arsimore
Fusha: Shërbime
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim + Rekomandim